

REVISTA JURIDIKE SHQIPTARE

Aspekte të krijimit dhe të veprimtarisë
gjyqësore të Dhomave të Specializuara të
Kosovës dhe roli i Republikës së Shqipërisë

KEJSI ZIU



Financuar nga
Bashkimi Evropian



PUBLIKUES

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)
Rr. Milto Tutulani, Nd.1, Ap. 4. (Dora D'Istria)
Tirana 1019, Albania
Tel: +355 44 104 247
E-mail: info@em-al.org
Web: www.em-al.org

AUTORË

Kejsi Ziu, Revista Juridike Shqiptare*

VITI I PUBLIKIMIT

Nëntor, 2023

Kejsi Ziu është aktualisht Drejtore e Drejtorisë Ligjore të Autoritetit të Mediave Audiovizive në Shqipëri (AMA). Gjatë periudhës 2018-2022, ajo ka shërbyer si përfaqësuese diplomatike në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Vendeve të Ulëta. Ajo ka punuar për disa vite në organizatat e shoqërisë civile të angazhuara në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe demokratizimit në Shqipëri. Ziu është diplomuar me një Master Ligjesh në të Drejtën Europiane në Universitetin Radboud, Holandë, si dhe ka përfunduar studimet në Drejtësi pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtaresimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Lëvizjes Europiane në Shqipëri, Revistës Juridike Shqiptare dhe autorëve, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Projekti "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtaresimit në BE", po zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian - IPA Civil Society Facility and Media 2021, në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI)



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Hyrje	03
Historiku i themelimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar:	04
Baza ligjore	06
Dhomat e Specializuara të Kosovës, si një gjykatë ndërkombëtare sui generis	07
Veprimtaria gjyqësore e Dhomave të Specializuara të Kosovës	08
Aspekte për diskutim	10
Roli i Shqipërisë	11
Përfundime	13

Që prej përfundimit të konfliktit në Kosovë në vitin 1999, shumë nga gjykatat apo tribunalet ndërkombëtare dhe ato vendore kanë shërbyer si forume kryesore ligjore për hetimin e krimeve më të rënda të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit në territorin e Kosovës. Themelimi i Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar në vitin 2015, është pasqyruar si përpjekja më e fundit në vazhden e këtyre gjykimeve, por duke përfshirë një grup specifik të krimeve të pretenduara të luftës akuzuar se janë kryer nga disa pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) gjatë dhe menjëherë pas konfliktit të dhunshëm në vend. Veprimtaria gjyqësore e Dhomave të Specializuara të Kosovës (DhSK) dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar kanë qenë në qendër të vëmendjes së diskursit politik shqiptar dhe atij ndërkombëtar veçanërisht përgjatë dy viteve të fundit, kjo kryesisht për shkak të aktakuzave të lëshuara dhe subjekteve nën gjykim aktualisht nga kjo gjykatë ndërkombëtare. Gjykata Speciale e Kosovës ligjërisht konsiderohet si pjesë e sistemit gjyqësor të brendshëm të Kosovës, por de facto ajo gëzon shumë pak legjitimitet të perceptuar nga publiku i Kosovës. Selia e saj është e vendosur jashtë territorit të Kosovës, pothuajse i gjithë stafi thelbësor gjyqësor e teknik i kësaj gjykate nuk numëron asnjë shtetas të Kosovës (apo të Shqipërisë). Gjithashtu, mandati i gjykatës fokusohet ekskluzivisht në gjykimin e akuzave të ngritura ndaj disa prej ish-anëtarëve të UÇK[1]-së, mbajtës të karrierave më të spikatura në politikëbërjen e historisë së Republikës së Kosovës.

Vlen gjithashtu të theksohet se diskursi mbi Gjykatën ka një rëndësi të veçantë edhe për Republikën e Shqipërisë. Një aspekt gjerësisht i diskutuar është përfshirja në këtë Raport e një zone në veri të Shqipërisë, e cila pretendohet

të jetë përdorur nga këta anëtarë të UÇK-së për kryerjen e një prej krimeve më të rënda kundër njerëzimit, atë të trafikimit të organeve. Aktualisht, Republika e Shqipërisë është angazhuar ndërkombëtarisht në një fushatë mjaft aktive diplomatike që synon të paraqesë pretendimet e paraqitura në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës (2011)[2] mbi trafikimin e organeve, të cilat u bënë fillesa kryesore e krijimit të Gjykatës, si të pabazuara në fakte e prova. Në gusht 2022, Qeveria e RSH parashtrroi zyrtarisht pranë Këshillit të Europës kërkesën për rrëzimin e Raportit të miratuar në 2011, me pretendimin që ekzistenca e tij, e për rrjedhojë e vetë Gjykatës, rrezikojnë të cenojnë padrejtësisht legjitimitetin e përpjekjeve për pavarësinë e Kosovës si një shtet demokratik e i pavarur.

Pavarësisht polemikave që rrethojnë origjinën e krijimit dhe veprimtarisë së Gjykatës, synimi kryesor i këtij shkrimi është së pari, të analizojë bazën ligjore të krijimit, mënyrës së organizimit dhe veçorive përkatëse të Dhomave të Specializuara, të analizojë aktakuzat dhe vijimësinë e proceseve të deritanishme gjyqësore ndaj ish-anëtarëve të UÇK-së nën gjykim, si dhe së dyti, të parashtrrojë disa opinione të autores mbi rolin që mund të luajë Shqipëria në veprimtarinë vijuese të DHSK-së dhe ZPS-së. Artikulli do të mbështetet në tre shtylla diskutimi, si më poshtë vijon:

- I. Origjina e krijimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar, baza ligjore, juridiksioni që mbulon, si dhe funksionimi i kësaj gjykate, krahasuar me gjykatat e tjera ndërkombëtare penale;
- II. Aktakuzat, ecuria dhe afatet kohore të proceseve gjyqësore në shqyrtim;

III. Aspekte të rolit të Republikës së Shqipërisë në marrëdhënien Kosovë-DHSK, bashkëpunimi aktual i RSH-së me Gjykatën, si dhe sugjerime mbi rolin e shtetit shqiptar në ekzistencën e Gjykatës në të ardhmen.

Historiku i themelimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar

Raporti trefaqësh i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës (KiE), titulluar "Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë"[3], hartuar asokohe nga anëtari zviceran i Asamblesë z. Dick Marty[4], u publikua më 7 janar 2011 dhe u miratua nga Asambleja Parlamentare e KiE më 23 janar 2011. Është thelbësore të theksohet se ky raport ishte produkt i një Projekt-Rezolute të mëparshme[5], e propozuar nga deputetët e partive ruse prezentë në Asamble, si dhe mbështetur nga Serbia dhe 14 shtete të tjera.[6] Në projekt-rezolutën e propozuar nga Federata Ruse, kërkohet që Asambleja Parlamentare e KiE të hetonte trajtimin çnjerëzor dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë, ashtu siç përshkruhen në librin e kujtimeve të Carla Del Ponte, ish-prokurore e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen e Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë (ICTY) që nga viti 1991.[7] Citimet në projekt-rezolutë të librit të Del Ponte[8] pretendonin se militantët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kishin marrë me forcë më shumë se 300 persona nga enklavat serbe të Kosovës, të cilëve më vonë u hoqën organet e rëndësishme jetësore. Sipas Del Ponte, organet u trafikuan më pas nëpërmjet aeroportit të Rinasit në Tiranë në klinika të

huaja për transplantim organesh me pagesë. Ajo shkruante për "një numër të madh dokumentesh" që i vërtetonin krimet e mundshme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe se kishte sinjale se lidhshipi më i lartë politik i Kosovës ishte i përfshirë në kryerjen e tyre.

Në përgjigje të projekt-rezolutës, Asambleja Parlamentare e KiE e ngarkoi Dick Marty-n të hartonte raportin në fjalë, i cili pretendonte të konfirmonte të njëjtat akuza ndaj UÇK-së si libri i Del Ponte. Raporti i tij ngrinte akuza serioze për krime lufte dhe identifikonte autorët e dyshuar me emër.[9] Dick Marty nuk i paraqiti kurrë provat që pretendonte se kishte gjetur gjatë hartimit të raportit e pavarësisht kësaj, ky dokument u miratua në tërësi dhe fjalë për fjalë në Rezolutën e Këshillit të Europës. [10]

Vetë rezoluta e KiE e përmend trafikimin e organeve jo më pak se tetë herë dhe kërkon angazhimin e të gjithë partnerëve përkatës, si misioni i BE-së për sundimin e ligjit në Kosovë, EULEX-i, apo TPNJ-ja dhe institucionet shtetërore të Kosovës, Shqipërisë dhe Serbisë, që të bëjnë gjithçka të nevojshme për të siguruar që autorët të mbajnë përgjegjësi dhe drejtësia të vihet në vend.[11] Pas publikimit të raportit të Marty-t, në shtator të vitit 2011, EULEX[12] autorizoi krijimin e Task Forcës Hetimore Speciale të BE (TFHS)[13] të kryesuar nga Clint Williamson, ish-ambasadori i SHBA-së për krime lufte, për kryerjen e një hetimi të pavarur në terren të pretendimeve të ngritura në atë dokument.

Mandati i task-forcës e bëri shumë të qartë rëndësinë e raportit të Marty-t në formën që u miratua nga rezoluta e Këshillit të Europës,

duke specifikuar se ajo u krijua për të hetuar dhe nëse nevojitej, për të ndjekur penalisht persona fizikë për krimet e supozuara në raport. [14]

Është mjaft e qartë që ndërhyrja e BE-së ka luajtur rol vendimtar në krijimin e Dhomave dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Këshilli i Bashkimit European u kërkoi institucioneve të Kosovës si parakusht për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit përfundimin prioritar të hapave të nevojshëm për themelimin e një gjykate të specializuar në kontekstin e hetimit nga EULEX SITF për pretendimet e krimeve të luftës dhe pretendimet për krim të organizuar”, të përfshira në raportin e KiE-së. [15]

Në korrik të vitit 2014, pas kryerjes së disa vizitave hetimore në Republikën e Kosovës, Williamson publikoi një raport të gjetjeve të task-forcës dhe deklaroi se grupi i punës ishte në gjendje të ngrinte disa aktakuza kundër disa zyrtarëve të lartë të UÇK-së (i pa-identifikuar me emër), për llojet e krimeve të përshkruara në raportin e Marty-t. Krahas akuzave të diskutuara mbi trafikimin e organeve, raporti i SITF shqyrtoi në tërësi edhe pretendimet për heqje të paligjshme lirie, dëbim, akte çnjerëzore, tortura dhe vrasje, si dhe çdo krim tjetër lufte i përfshirë në raportin e KiE. TFHS-ja i raportoi BE-së se ekzistonin prova të mjaftueshme për të ngritur aktakuzat, por për shqyrtimin e këtyre pretendimeve ishte i nevojshëm krijimi i një institucioni të përshtatshëm për procedimin e duhur gjyqësor.[16] Kryetari Williamson rekomandoi krijimin e një gjykate speciale për shqyrtimin e aktakuzave, në vend të vetë aparatit gjyqësor ekzistues të EULEX-it në Kosovë. Komuniteti ndërkombëtar në Kosovë u pajtua me këtë përfundim, duke e parë si më mirë ndjekjen

penale të 'peshqve të mëdhenj' si Thaçi, Veseli dhe figura të tjera të shquara të UÇK-së që nuk u ndoqën asnjëherë penalisht nga EULEX-i, në një vendndodhje neutrale jashtë Kosovës, pa ndërhyrje politike e më e sigurt për dëshmitarët, nga një staf tërësisht ndërkombëtar.[17]

Ndërsa, lidhur me akuzën e trafikimit të organeve, Williamson u shpreh asokohe se një numër i vogël individësh ishin vrarë me qëllim nxjerrjen dhe shitjen e organeve të tyre dhe se “ky përfundim ishte në përputhje me atë që thuhej në Raportin e Marty-t, ku specifikisht vetëm një “grup i vogël individësh kishin qenë viktima të këtij krimi”. Është megjithatë e rëndësishme të theksohet se raporti i Task Forcës nuk kishte mbledhur prova të mjaftueshme në mbështetje të kësaj akuze.[18]

Nën kushtet e presionit të vazhdueshëm nga Bashkimi European dhe komuniteti ndërkombëtar, në 2015 Qeveria e Kosovës arriti marrëveshje zyrtare me BE-në mbi modalitetet e zhvillimit të gjyqimit lidhur me këto pretendime.[19] Më 3 gusht të vitit 2015, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi ndryshimet në Kushtetutë, [20] me qëllim krijimin e Gjykatës dhe miratoi Ligjin për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.[21] Gjykata e filloi ushtrimin e veprimtarisë së saj në korrik të vitit 2017 dhe selia e saj ndodhet në Hagë, Holandë. [22]

Pas një periudhe trevjeçare hetimesh nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, aktakuzat u ngritën më në fund në vitin 2020, duke akuzuar për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte Hashim Thaçin, Presidentin e Kosovës në atë kohë, (i cili dha menjëherë dorëheqjen), Kadri Veselin, i cili deri një vit përpara arrestimit mbante pozicionin e Kryetarit të Kuvendit,

si dhe figura të tjera të shquara të UÇK-së. Veçanërisht për t'u theksuar është fakti se asnjë nga aktakuzat nuk i referohet në asnjë moment pretendimit për trafikimin e organeve.[23]

Vendimi për themelimin e këtij organizmi gjyqësor ka qenë objekt i shumë kritikave, qoftë nga pikëpamja ligjore apo e të drejtave të njeriut, por edhe ajo politike: Republika e Kosovës është në listën e anëtarësimit në BE, e për këtë arsye BE-së i duhej të mbështeste hetimin e akuzave serioze të pretenduara në raportin e Marty-t, pasi mendohej se mekanizmat e atëhershëm të sundimit të ligjit të mbështetur nga BE-ja në Kosovë kishin shmangur ndjekjen e 'peshqve të mëdhenj' deri në atë moment. [24]

Sigurisht që çdolloj pretendimi mbi krime lufte të supozuara ia vlen të hetohet dhe të ndiqet penalisht, në mënyrë që drejtësia t'u shërbehet viktimave. Megjithatë, veprimtaria gjyqësore e DHSK-së ka dështuar në një aspekt të rëndësishëm: deri tani, të gjitha aktakuzat e ngritura nga kjo Gjykatë janë vetëm ndaj shtetasve të Kosovës, duke u fokusuar vetëm te krimet që supozohet se janë kryer nga njëra palë në konflikt. Mandati i kufizuar i DHSK-së për ndjekjen penale vetëm të krimeve të lidhura me UÇK-në është në fakt, edhe antagonizmi kryesor me të cilin po përballet imazhi i kësaj Gjykate kundrejt një pjesë të gjerë të popullsisë së Republikës së Kosovës.

Baza ligjore

Bazuar në diskutimin e deritanishëm mbi origjinën e krijimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës, por edhe të ekzistencës së institucioneve të ngjashme të së drejtës ndërkombëtare, mund të argumentohet se

se shpeshherë, vullneti i përbashkët politik përbën instrumentin kryesor për themelimin e organizmave ligjorë ndërkombëtarë. E megjithatë, personaliteti juridik i një gjykate apo tribunali të kësaj natyre buron ose nga traktatet (dypalëshe apo shumëpalëshe) mes shteteve, apo mes shteteve dhe personave juridikë ndërkombëtarë, të cilët e kanë shprehur qartë pëlqimin e tyre për ta lidhur këtë marrëveshje[25], ose nën autoritetin e një organizate ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara (KB).[26]

Në rastin konkret, është e diskutueshme nëse Shkëmbimi i Letrave mes Presidentes së Republikës së Kosovës dhe Përfaqësueses së Lartë të BE-së (2014)[27] përbën ose jo në vetvete një traktat të lidhur përkatësisht mes një shteti sovran dhe një organizate ndërkombëtare, siç është në këtë rast Bashkimi Europian, nga i cili të burojnë personaliteti juridik i Dhomave të Specializuara. Autorja është e mendimit që shkëmbimi i letrave krijoi ligjërisht detyrimin ndërkombëtar të Republikës së Kosovës për marrjen e masave përmbushëse, por ishin ndryshimi i Kushtetutës dhe miratimi i Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, legjislacioni themelues për krijimin e personalitetit juridik të saj.[28]

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka parashikuar një mandat të paktën pesë vjeçar për Gjykatën speciale në momentine amendimit të saj, i cili mund të zgjatet për një kohë të pacaktuar, derisa Këshilli i Europës të vendosë për ndërprerjen e funksioneve.[29] Mandati fillestar i gjykatës përfundoi në vitin 2020 dhe veprimtaria e saj u zgjat automatikisht përtej kësaj date.[30]

Ligji Nr. 05/L-053 i Republikës së Kosovës për Dhomat dhe Zyrën e Prokurorisë së Specializuar parashikon personalitet të plotë ligjor dhe juridik për të dyja organet kryesore të Gjykatës.[31] Pavarësisht se ligji bazë i Dhomave të Specializuara u hartua dhe miratua nga organet përgjegjëse së Republikës së Kosovës dhe gjykata konsiderohet si pjesë e sistemit të brendshëm gjyqësor kosovar, dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-053 dëshmojnë mbi disa elementë thelbësorë që e konfirmojnë natyrën ndërkombëtare e të veçantë të kësaj gjykate.[32]

Në mënyrë të përmbledhur, mund të thuhet se baza ligjore për Dhomat e Specializuara të Kosovës gjendet në tre burime të ndryshme normative: në atë kushtetues, të zakonshëm dhe atë ndërkombëtar.

Dhomat e Specializuara të Kosovës, si një gjykatë ndërkombëtare sui generis

Modele të ngjashme gjykatash ndërkombëtare si DHSK-ja janë të shumta. Këtu mund të përmendim Gjykatën Ndërkombëtare Penale (ICC)[33], Gjykatën Penale Ndërkombëtare për Ruandën (ICTR)[34], Gjykatën Speciale për Libanin[35], etj, shumica e selive të cilave janë gjithashtu të vendosura në Hagë. Dhomat e Specializuara të Kosovës paraqesin një formë të re të të ashtuquajturave “gjykata hibride”, sepse përbëhet në mënyrë ekskluzive nga gjyqtarë dhe personel ndërkombëtar dhe nuk përfshin gjyqtarë të Kosovës. Në këtë aspekt, DHSK-ja ndryshon nga modele të tjera të njohura të gjykatave të tjera “hibride”, qoftë në formën e gjykatave vendase të ndërkombëtarizuara, apo tribunaleve

ndërkombëtare të cilat kanë një komponent kombëtar, që në shumicën e rasteve, është përfshirja e gjyqtarëve vendas. Gjithashtu, Zyra e Prokurorit të Specializuar është një organ i pavarur dhe nuk merr udhëzime nga asnjë qeveri apo burim tjetër, si dhe nuk ndan asnjë informacion me autoritetet e Kosovës. Prokurori i Specializuar emërohet nga kreu i EULEX-it.

Organizmi ligjor ndërkombëtar më i krahasueshëm me DHSK-në, për sa i përket elementeve të juridiksionit territorial dhe atij personal, objektit dhe mandatit të krijimit, është Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (ICTY). ICTY, ashtu si DHSK-ja, ka patur juridiksion vetëm mbi individët dhe jo organizata, parti politike, njësi të ushtrisë, subjekte administrative apo persona juridikë. [36] Po ashtu, ligji për krijimin e Dhomave të Specializuara[37] nuk shpreh në asnjë moment se mandati i Gjykatës do të shtrihet vetëm në hetimin apo ndjekjen penale të shqiptarëve të Kosovës, apo ish-pjesëtarëve të UÇK-së.

Brenda juridiksionit lëndor të tyre, Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë përparësi mbi të gjitha gjykatat e tjera të Republikës së Kosovës. [38] Në mënyrë të ngjashme, edhe ICTY ka pasur juridiksion të njëkohshëm mbi shkeljet serioze të ligjeve humanitare ndërkombëtare të kryera në ish-Jugosllavi dhe në çdo fazë të gjykimit nga gjykatat në nivel kombëtar, ICTY mund të pretendonte përparësi ndaj hetimeve, ose të referonte rastet e tij autoriteteve kombëtare kompetente në Ish-Jugosllavi.

Megjithatë, veprimtaria e Dhomave të Specializuara ndryshon me atë të ICTY-së në disa aspekte thelbësore të juridiksionit lëndor dhe kohor, si më poshtë:

- Sa i takon juridiksionit lëndor, Dhomat e Specializuara të Kosovës janë mandatuar të hetojnë e gjykojnë mbi krime kundër njerëzimit, krime lufte dhe krime të tjera të parashikuara në legjislacionin e Republikës së Kosovës.[39] Ndërsa, ICTY ka pasur juridiksion për të ndjekur penalisht dhe gjykojë individët për katër kategori veprash: -shkelje të rënda të konventave të Gjenevës të vitit 1949, shkelje të zakoneve, gjenocid dhe krime kundër njerëzimit.[40]
- Sa i takon juridiksionit kohor, DHSK-ja ka një mandat të limituar për të hetuar veprat penale të pretenduara në raportin e vitit 2011 të Raportuesit Special të Këshillit të Europës, Dick Marty, gjatë periudhës 1 janar 1998 - 31 dhjetor 2000, të kryera nga shtetas së Ish-Republikës Jugosllave (IRJ) dhe/ose të Kosovës, apo të kryera kundër personave me shtetësi kosovare dhe/ose të IRJ, kudo që janë kryer këto vepra penale[41]. Në përputhje me Statutin e saj, ICTY ka pasur juridiksion mbi territorin e ish-Jugosllavisë që nga viti 1991 e në vazhdim.[42]
- Në ndryshim nga ICTY, e cila u themelua si gjykatë ad hoc nga Kombet e Bashkuara dhe statuti i saj[43] u krijua sipas modeleve ekzistuese të së drejtës ndërkombëtare penale, DHSK-ja udhëhiqet nga statutet ligjore të Republikës së Kosovës dhe vepron sipas çdo shkalle të sistemit gjyqësor kosovar, konkretisht: Gjykata Themelore e Prishtinës, Gjykata e Apelit, Gjykata Supreme dhe Gjykata Kushtetuese. Dhomat e Specializuara funksionojnë në bazë të ligjeve përkatëse të Kosovës, si dhe të drejtës zakonore ndërkombëtare e të drejtave ndërkombëtare të njeriut.[44]

Veprimtaria gjyqësore e Dhomave të Specializuara të Kosovës

Aktualisht, Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë në shqyrtim katër çështje, nga të cilat dy janë në fazën e gjykimit në shkallë të parë, një në Apel dhe një në Gjykatën Supreme,[45] por seksioni i këtij artikulli ka për qëllim të fokusohet vetëm në çështjen gjyqësore “Hashim Thaçi et al.”[46], duke marrë në analizë të gjithë elementët ligjorë dhe kohorë të saj, që prej konfirmimit të aktakuzës nga gjyqtari paraprak i DHSK-së, e deri në statusin aktual të gjykimit.

Aktakuza: Aktakuza e parë kundër katër të akuzuarve u konfirmua më 26 tetor 2020 dhe u bë publike më 5 nëntor 2020.[47] Në aktakuzën e konfirmuar pretendohet se Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi[48] mbajnë përgjegjësi penale individuale në bazë të formave të ndryshme të përgjegjësisë penale, për krimet e paraqitura në aktakuzë, që u kryen në kontekstin e një konflikti të armatosur jo-ndërkombëtar në Kosovë dhe në kuadrin e një sulmi gjerësisht të përhapur dhe sistematik kundër personave të dyshuar si kundërshtarë të UÇK-së.[49] Pas arrestimit të tyre nga Prokurori i Specializuar, Thaçi, Veseli, Selimi and Krasniqi u transferuan në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë, më 4 dhe 5 nëntor 2020.

Në aktakuzën e konfirmuar thuhet se së paku midis marsit 1998 dhe shtatorit 1999, u kryen krimet e luftës, të arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrarisht, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme dhe krimet kundër njerëzimit të burgosjes, akteve të tjera çnjerëzore, torturës, vrasjes së paligjshme,

zhdukjes me forcë të personave dhe përndjekjes. Krimet që paraqiten në aktakuzë u kryen në disa vende në Kosovë, si edhe në Kukës dhe Cahan në Shqipërinë Veriore dhe u kryen nga anëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”) kundër qindra civilëve dhe personave që nuk merrnin pjesë aktive në luftime.

Ndër viktimat e pretenduara përfshiheshin persona që dyshoheshin si kundërshtarë të UÇK-së dhe më vonë të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, konkretisht: (i) serbë, romë dhe ashkalinj; (ii) katolikë; (iii) civilë për të cilët pretendohet se bashkëpunonin me autoritetet serbe ose që pretendohet se kontaktonin me serbë; (iv) shqiptarë që ishin anëtarë ose përkrahës të Lidhjes Demokratike të Kosovës ose të partive të tjera që konsideroheshin se ishin kundër UÇK-së; (v) shqiptarë që nuk iu bashkuan ose nuk përkrahnin UÇK-në; dhe (vi) individë të punësuar ose të punësuar të mëparshëm që konsideroheshin kundër UÇK-së. [50]

Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi akuzohen në bazë të përgjegjësisë penale individuale (neni 16(1)(a) i Ligjit) dhe në bazë të përgjegjësisë penale superiore (neni 16(1)(c) i Ligjit) për kryerjen e:

- Krimeve kundër njerëzimit (përndjekje, burgim, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje dhe zhdukje me forcë të personave sipas nenit 13 të ligjit),

si dhe

- Krimeve të luftës (arrestim dhe ndalim i paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje, sipas nenit 14 të ligjit). [51]

Faza e procedurës paraprake: Seancat e paraqitjes së parë të Thaçit dhe Krasniqit u mbajtën më 9 nëntor 2020 para Gjykatës të Procedurës Paraprake, Nikola Giju. Gjatë këtyre seancave, ata u vetëdeklaruan të pafajshëm në lidhje me gjitha pikat e aktakuzës. Ndërsa, seancat e paraqitjes së parë të Veselit dhe Selimit u mbajtën përkatësisht më 10 dhe 11 nëntor. Të dy të akuzuarit u vetëdeklaruan të pafajshëm në lidhje me të gjitha akuzat.

Më 22 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, përmes dy vendimeve, miratoi pjesërisht mocionet e Mbrojtjes dhe urdhëroi Zyrën e Prokurorisë së Specializuar që të korrigjojë dhe ndryshojë aktakuzën, mes të tjerash, duke përjashtuar përgjegjësinë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale III për krime me synim konkret (tri apele kundër këtij vendimi, të dorëzuara nga Thaçi, Selimi dhe Krasniqi, u hodhën poshtë nga Gjykata e Apelit më 22 gusht 2022). ZPS-ja e dorëzoi aktakuzën e ndryshuar më 3 shtator 2021.

Më 17 dhjetor 2021, ZPS-ja e dorëzoi duke e cilësuar si ‘reptësisht konfidenciale’ dhe ex parte dosjen e saj paraprake.[52] Më 23 dhjetor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi kërkesën e ZPS-së për ndryshim të aktakuzës me qëllim që të përfshijë një numër akuzash të reja, konkretisht qendra ndalimi të tjera në komunën e Suharekës, incidente të reja të përndjekjes dhe vrasjes së paligjshme në Gjilan, si dhe incidente të reja të pjesëmarrjes personale të të akuzuarit në krimet për të cilat akuzohet. Pas hedhjes poshtë të apeleve të Thaçit dhe Veselit kundër këtij vendimi prej Panelit të Gjykatës së Apelit më 22 mars 2022, ZPS-ja dorëzoi versionin e redaktuar publik të aktakuzës së ndryshuar më 29 prill 2022.[53]

Më 10 maj 2022, gjatë paraqitjeve të tyre, të katër të akuzuarit u vetëdeklaruan përsëri si të pafajshëm lidhur me akuzat e reja në aktakuzën e ndryshuar, të dorëzuar më 29 prill 2022.

Më 22 korrik 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi, pjesërisht, kërkesën e Mbrojtjes së Thaçi që pretendonte mangësi në aktakuzën e fundit dhe gjithashtu urdhëroi ZPS-në që, deri më 30 shtator 2022, të parashtronte aktakuzën e ndryshuar më tej, me informacion shtesë lidhur me akuzat. Informacioni shtesë kishte të bënte me emrat e autorëve të drejtpërdrejtë të krimeve, viktimave dhe vendndodhjeve përkatëse në paragrafet konkrete në aktakuzën aktuale.

Më 30 nëntor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Nikola Giju, njoftoi Presidenten e DHSK-së se dosja e çështjes do të jetë gati për t'ia kaluar Trupit Gjyqësor më datë 15 dhjetor 2022. Më 15 dhjetor 2022, gjykatësi i procedurës paraprake ia kaloi dosjen e çështjes trupit gjyqësor II.

Konferenca e parë përgatitore për gjykim u mbajt më 18 janar 2023, pasuar nga Konferenca Përgatitore e Prokurorit të Specializuar më 15 shkurt. Gjithsej, janë mbajtur 20 seanca gjyqësore, të ashtuquajtura “Konferenca përgatitore për gjykimin”, në të cilat janë diskutuar aspekte procedurale mbi mënyrën dhe kohëzgjatjen e paraqitjes së pretendimeve të palëve në gjykim, provave nga ana e ZPS, planifikimit të fillimit të gjykimit, etj.[54]

Faza e gjykimit: Gjykimi i çështjes “Thaçi et al.” filloi më 3 prill 2023, me deklaratat hyrëse të Prokurorit të Specializuar dhe të përfaqësuesit të viktimave, ndjekur nga ekipet e mbrojtjes më 4 dhe 5 prill 2023. Gjykatës në këtë fazë janë:

Çarls Smith III (kryesues), Kristof Barte, Genël Metro dhe Fergal Gejnor (gjykatës rezervë).

Disa aspekte për diskutim

Disa elemente juridike të cilët e rrethojnë ushtrimin e veprimtarisë së DHSK-së dhe SPZ-së gjatë hetimit dhe gjykimit të çështjes “Thaçi et al.”, e të cilat nevojitet të sillen në vëmendjen publike, janë të parashtruara në vijim.

Parimi i konfidencialitetit kundrejt të drejtës për informim: Një ndër parimet tashmë të pranuar në mbrojtjen e integritetit të proceseve gjyqësore në tribunale të ndërkombëtarë penalë, është ai i ruajtjes së konfidencialitetit. Ky mjet i shërben mbrojtjes së dëshmitarëve dhe identitetit të viktimave, si dhe moscenimit të pavarësisë së misionit të këtyre gjykatave. E megjithatë, është e rëndësishme që të respektohet balanca mes këtij parimi, e nga ana tjetër, të zbatimit të një procesi transparent e ligjor, ku respektohen të drejtat procedurale të të pandehurve. Në rastin konkret me DHSK-në, katër të akuzuarit në çështjen “Thaçi et al.” janë ndaluar përpara se të kishin kohën e mjaftueshme të njiheshin me versionin e parredaktuar të aktakuzës së ngritur kundër tyre, e cila është amenduar nga SPZ-ja dy herë të tjera, që pas momentit të konfirmimit të saj në 2020. Së dyti, në vijim, skuadrat e tyre mbrojtëse kanë hasur në pengesa për të pasur akses në dokumentet zyrtare të ZPS-së, me qëllim përgatitjen e parashtrimit të mbrojtjes së të përfaqësuarve.

Zëdhënësit e DHSK-së dhe të ZPS-së kanë dhënë disa arsye mbi mosbërjen publike të versioneve të plota të dokumenteve, duke sqaruar se për qëllime të ruajtjes së privatësisë të palëve, në një çështje të caktuar, disa seanca

gjyqësore mund të kalojnë në seancë private edhe pse procedurat e gjykimit në parim janë publike. Masa të tilla urdhërohen nga gjyqtarët, zakonisht për arsye sigurie, e për të mbrojtur dëshmitarët ose viktimat.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se, në optikën e ruajtjes së parimit të publicitetit të gjykimit, dosjet konfidenciale rishikohen rregullisht dhe sa herë që arsyeja që justifikon klasifikimin e tyre si “konfidenciale” nuk ekziston më, ato riklasifikohen si versione publike ose të redaktuara publike.

Së treti, pavarësisht se faza e procedurës paraprake të gjykimit së kësaj çështjeje ka zgjatur për pothuajse tre vite, ZPS-ja ende nuk ka bërë të ditur për palët e akuzuara, një parashikim mbi kohëzgjatjen e gjykimit, apo të japë informacion mbi faktet që disponon. Në bazë të nenit 21(6) të Ligjit për DHSK-në, të gjitha provat materiale dhe relevante ose faktet që disponon ZPS-ja, të cilat janë pro ose kundër të akuzuarit, duhet t'i vihen në dispozicion të akuzuarit përpara fillimit dhe gjatë procedimit, më përjashtim vetëm të kufizimeve të cilat janë rreptësisht të nevojshme dhe kur zbatohet çdo mbrojtje e nevojshme ndaj të akuzuarit. Gjithashtu, në bazë të rregullit 102(3) të Rregullores për Procedurën dhe Provat para Dhomave të Specializuara të Kosovës, SPZ-ja duhet t'i japë mbrojtjes një njoftim të detajuar për çdo material dhe provë që ajo posedon.[55]

Lidhur me të gjithë elementët e sipërcituar, është thelbësore të theksohet se respektimi i të drejtave themelore procedurale të gjykimit nga çdolloj organizmi ndërkombëtar penal, si DHSK-ja, shërben për të përforcuar legjitimitetin e atij organizmi, si dhe besimin e publikut të gjerë në veprimtarinë e tij.

Roli i Shqipërisë

Së pari, vlen të përmendet që neni 55, pika 1 e ligjit, si dhe rregulli 208 i Rregullores për funksionimin e DHSK-së, parashikojnë modalitetet ekzistuese të bashkëpunimit mes Republikës së Shqipërisë dhe DHSK-së. Konkretisht, në respektim të këtyre dispozitave, Ministria e Drejtësisë e RSH-së apo autoritetet e tjera përgjegjëse shqiptare, bashkëpunojnë me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe pa vonesë respektojnë çdo kërkesë për asistencë ose për zhvillimin e hetimeve dhe ndjekje penale të personave që akuzohen për kryerjen e krimeve brenda juridiksionit lëndor të Dhomave të Specializuara, si dhe për përmbushjen e përgjegjësisë të tjera të DHSK-së. Rezulton se gjatë periudhës së ushtrimit të veprimtarisë së Gjykatës, ky bashkëpunim ka rezultuar i suksesshëm.

Ndërsa, nga pikëpamja e kontributit politik të shtetit shqiptar në diskursin lidhur me procedimin e ish-pjesëtarëve të UÇK-së nga Gjykata, Kuvendi i Shqipërisë në 21 korrik të vitit 2022 miratoi një rezolutë të propozuar nga qeveria, duke e dënuar raportin e Marty-t dhe duke i përshkruar pretendimet e tij si të pabaza. Njëpërmjet rezolutës, iu kërkua Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës të hartojë një raport pasues ndaj atij të Marty-t dhe të rishikojë pretendimet e ngritura në atë raport. [56] Më 12 gusht të këtij viti, Shqipëria dorëzoi zyrtarisht kërkesën për rishikim të Rezolutës së Këshillit të Europës të vitit 2011 në Asamblenë Parlamentare të KiE.[57]

Por, a mund të zhbëhej realisht rezoluta e Dick Marty-t nga KiE? Shqipëria ndoqi disa procedura konkrete ligjore me qëllim vënien në

lëvizje të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës. Hapi i parë ishte paraqitja e një mocioni për Rezolutë, kërkesë e cila u mor në shqyrtim nga Byroja parlamentare, pas verifikimit se ishte në respektim të procedurave të saj. Sipas këtij rregulli, një mocion për rekomandim apo rezolutë duhet të nënshkruhet nga të paktën 20 përfaqësues, që u takojnë pesë delegacioneve kombëtare, ose duhet të miratohet me kuorumin e nevojshëm nga një nga komisionet e këshillit. Më 3 prill 2023, qeveria shqiptare njoftoi se i kishte mbledhur nënshkrimet e nevojshme dhe kërkesa u paraqit si dokument i Asamblesë dhe u vendos në rendin e ditës të debatit plenar. Më 23 prill 2023, Këshilli i Europës vendosi të mos e mbështesë kërkesën e qeverisë shqiptare për rrëzimin e raportit të Marty-t.[58] Kjo ishte e pritshme, duke marrë në konsideratë faktin se rrëzimi i një dokumenti zyrtar të miratuar nga vetë Asambleja Parlamentare e KiE do të vendostë një precedent jo të favorshëm për punën e kësaj organizate në të ardhmen.

Krahas ecurisë së lobimit nëpërmjet kanaleve të zakonshëm diplomatikë të RSH-së, një sugjerim i autores mbi përfshirjen ligjore të Shqipërisë në gjykimin e çështjes “Thaci et al.” në vijim, do të ishte paraqitja e parashtrimeve në cilësinë e “amicus curiae”. [59] Ky instrument është mjaft i njohur në të drejtën ndërkombëtare dhe është përdorur nga shtete të tjera të cilat mund të kenë interes në zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje në gjykata të tilla si GJNP, GJND, etj. Në cilësinë e “amicus curiae” Shqipëria do të konsiderohej si një subjekt ndërhyrës, jo në cilësinë e palës në gjykim, që ofron parashtrësia ligjore në mënyrë që të njohë gjykatën me një alternativë ose perspektivë shtesë në lidhje me mosmarrëveshjen.

Rregullorja për DHSK-në gjithashtu e parashikon këtë mundësi, ku konkretisht rregulli 67, pika 1 e saj citon se: “Në cilëndo fazë të procesit, një panel mund të ftojë ose të lejojë autoritetet e Kosovës, një shtet të tretë, organizatë, ose person, të paraqesin parashtrime në cilësi të amicus curiae në lidhje me cilëndo çështje që paneli e gjykon të përshtatshme dhe që mund të ndihmojë marrjen e vendimit të duhur për çështjen gjyqësore.” Në opinionin tim, kjo do të garantonte përfshirjen aktive të RSH-së në gjykim, e njëkohësisht do të shërbente si një garanci më shumë për shqyrtimin e çështjes me objektivitet nga instancat e DHSK-së.

Pavarësisht se është e padiskutueshme se themelimi dhe mandati i DHSK-së është një hap fisnik drejt adresimit së kulturës së mosndëshkimit për krimet e luftës, duhet përmendur se nismat aktuale të kësaj Gjykate për t'i gjykuar këto pretendime, kanë zbuluar sfidat e drejtësisë tranzicionale në Kosovë. Konkretisht, krijimi i DHSK-së si një gjykatë vendase e ndërkombëtarizuar, ose me fjalë të tjera, një gjykatë hibride, por pa asnjë element kombëtar të Kosovës, i dëmton rëndë shanset e saj për të pasur sukses, si në aspektin e aftësisë për të ndjekur penalisht dhe mbledhjen e provave ndaj të pandehurve, ashtu edhe dhe aftësinë e saj për të fituar respekt dhe legjitimitet në mbarë Kosovën.[60]

Mënyra për të arritur drejtësi për krimet dhe për të ndihmuar Kosovën në përballimin e historisë së saj traumatike është të mos vazhdohet me metodat problematike të përdorura në të kaluarën, e të vendosurit të drejtësisë nga aktorë të jashtëm (si në rastin e krijimit të ICTY). Populli kosovar duhet të lejohet të luajë një rol në procesin gjyqësor dhe, në mënyrë demokratike, të japë zërin e tij mbi mënyrën dhe çfarë lloj drejtësie i ofrohet. Në vend të një gjykate të operuar ndërkombëtarisht e vendosur jashtë territorit nga ku ndodhi Lufta e Kosovës, komuniteti ndërkombëtar ka pasur disa alternativa më efektive për të garantuar sigurimin e drejtësisë në vend, si për shembull vazhdimin e operacionit të gjykatave të EULEX-it, duke inkorporuar modifikime në mandatin e tyre, për të adresuar çështje të rëndësishme, si mbrojtja e dëshmitarëve apo mekanizma kundër ndërhyrjes së mundshme politike.

Duke vepruar kështu, EULEX-i do të kishte ruajtur natyrën e vërtetë hibride të përbërjes dhe strukturës së tij, duke siguruar në të njëjtën kohë mbikëqyrjen ndërkombëtare, si dhe do të kishte mbajtur gjykatat e vendosura brenda territorit të Kosovës, duke ruajtur kështu një lidhje gjeografike me popullatën vendase kosovare dhe duke lejuar vendasit dhe viktimat të marrin pjesë në procedurën penale. Ndonëse një qasje e tillë mund të ketë qenë e papërshtatshme për bashkësinë ndërkombëtare, nga pikëpamja e mungesës së llogaridhënies, do të kishte shërbyer ndoshta më shumë në promovimin e paqes dhe stabilitetit, si brenda Kosovës, ashtu edhe ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Duke i refuzuar këtë opsion dhe duke ngritur një gjykatë krejtësisht të re dhe ndërkombëtare jashtë territorit të Kosovës, BE-ja ka vendosur në plan të parë objektivat politike ndërkombëtare, në vend të nevojave të popullatës kosovare për drejtësi. Duke vepruar kështu, bashkësia ndërkombëtare nuk e ka konsideruar potencialin për drejtësi gjithëpërfshirëse dhe tranzicionale brenda Kosovës, si dhe të ardhmen e modelit hibrid të ndjekjes penale.

Së dyti, do të ishte e përshtatshme që autoritetet shqiptare dhe administrata e Kosovës të fillojnë një hetim serioz dhe të pavarur për të zbuluar të vërtetën e plotë në lidhje me pretendimet e listuara në raportin e vitit 2011 të Marty-t, me qëllim zbulimin e verifikimin e të gjitha fakteve ekzistuese, e diferencimin e të vërtetës prej aludimeve të pabaza.

Së fundmi, do të ishte thelbësore që DHSK-ja të zgjasë mandatin e saj për të përfshirë krimet e kryera edhe nga serbët në konflikt, lëvizje e cila do të rriste besimin e publikut në punën e gjykatës dhe do të ndihmonte të dyja palët të përballen me të kaluarën. Ndërkohë, partnerët ndërkombëtarë duhet të përdorin levat e tyre, me qëllim nxitjen e Serbisë për të ndjekur penalisht kriminelët e luftës të rangut të lartë në Serbi. Në fund të fundit, pajtimi mes dy vendeve kërkon që të dyja palët të njohin përgjegjësinë e tyre dhe të vijojnë rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian.

[1] Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) ishte forcë politiko-ushtarake e popullit shqiptar të Kosovës e cila ishte aktive gjatë viteve 1990–1999. UÇK-ja kishte zanafillën nga Lëvizja Popullore e Kosovës. Si Lëvizja Popullore, ashtu edhe UÇK-ja, e realizoi veprimtarinë e saj, si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës.

[2] Raport i titulluar, D.Marty, 07.01.2011.

[3] Raporti i titulluar “Trajtimi çnjerëzor i njerëzve dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë” (“Inhuman treatment of people and illicit trafficking in human organs in Kosovo”), Dok. Nr. 12462, 7 janar 2011, Komisioni për Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, Raportues: z. Dick MARTY, Zvicër, Aleanca e Liberalëve dhe Demokratëve për Europën, i aksesueshëm në faqen zyrtare të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës: <https://pace.coe.int/en/files/12608>

[4] <https://pace.coe.int/en/members/4023/marty>

[5] Mocioni për rezolutë, i paraqitur nga z. Konstantin KOSACHEV dhe anëtarë të tjerë të Asamblesë, Dok. Nr. 11574, 15 prill 2008, titulluar “Inhumane treatment of people and illicit trafficking in human organs in Kosovo”, e aksesueshme në I. Aspekte të rolit të Republikës së Shqipërisë në marrëdhënien Kosovë-DHSH, bashkëpunimi aktual i RSH-së me Gjykatën, si dhe sugjerime mbi rolin e shtetit shqiptar në ekzistencën e Gjykatës në të ardhmen.

[6] Ibid., fq. 2

[7] Shih <https://www.icty.org/>

[8] Titulli i librit të C. Del Ponte është: “Gjuetia: Unë dhe kriminelët e luftës”. Sipas asaj që shkruante Del Ponte në librin e saj, zyra e prokurorit kishte informacion se në vitin 1998 ushtarët e UÇK-së kapën qindra serbë, romë, shqiptarë dhe përfaqësues të grupeve të tjera etnike. “Disa nga të arrestuarit u mbajtën në stalla derrash, u rrahën, përdhunuan, disa u ekzekutuan, të tjerët thjesht u zhdukën”. Sipas disa publikimeve, mund të ketë pasur edhe shtetas të shteteve të tjera anëtare të Këshillit të Europës, në veçanti të Moldavisë, Federatës Ruse dhe Rumanisë” – citohet në këtë libër.

[9] Ibid., fq 2-3.

[10] Ibid.

[11] Raporti i Dick Marty citon se “Sipas informacioneve të mbledhura nga Asambleja Parlamentare dhe hetimeve penale në vijim, të dhëna të shumta konkrete dhe konvergjente konfirmojnë se disa serbë dhe disa shqiptarë kosovarë janë mbajtur të burgosur në vende të fshehta të paraburgimit nën kontrollin e UÇK-së në veri të Shqipërisë dhe i janë nënshtruar masave dhe trajtimit çnjerëzor dhe degradues, përpara se të zhduken përfundimisht”, theksohet në raport. Ai pretendon në raport se dhjetëra robër kryesisht serbë dyshohet se ishin dërguar në një “shtëpi të verdhë” pranë Burrelit në Shqipërinë qendrore nga qershori 1999 deri në maj 2000, ku organet e tyre u hoqën sistematikisht. Ata më pas do të transportoheshin nëpërmjet aeroportit ose bregdetit dhe do të dërgoheshin jashtë vendit.

[12] Misioni i Bashkimit Europian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) ka filluar në vitin 2008 si misioni civil më i madh i BE-së, në kuadër të Politikës së Përbashkët të Bashkimit Europian për Siguri dhe Mbrojtje.

[13] Shih edhe <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=1,10,251>

[14] Raport (S/2014/773) i Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurimit, më 31.10.2014, 13

[15] Raport (S/2015/74) i Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurimit, më 30.1.2015, 2. Shih edhe Raportin (S/2014/558), më datë 1.8.2014, 13.

[16] Shih <https://www.scp-ks.org/sq/zps/task-forca-hetimore-speciale>

[17] Neni 3, pika 1 e Ligjit nr. 05/L-053 për DhSK parashikon se Dhomat e Specializuara janë të pavarura në ushtrimin e funksioneve të tyre. Ligji është i aksesueshëm në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, si vijon: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11036>

[18] Megjithatë, Williamson thekson në raport se "për të ndjekur penalisht vepra të tilla, kërkohet një nivel provash që ne nuk e kemi siguruar ende". Po ashtu, në atë kohë, Matti Raatikainen, shef i njësisë për krimet e luftës të EULEX-it, u shpreh në atë periudhë se nuk ka asnjë provë për këtë rast. Me kalimin e viteve, politikanët dhe ata që janë përfshirë në hetimin e çështjes kanë vënë në dukje sfidat e rëndësishme logjistike pas një operacioni të tillë, duke pasur parasysh se rrugët në rajon në atë kohë ose ishin inekzistente, ose do të duheshin ditë për të kaluar, duke e bërë pothuajse të pamundur transportin e organeve.

[19] Shkëmbim Letrash midis Presidentes së Kosovës dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit European për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë në vitin 2014. Ligji për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit European mbi Misionin e Bashkimit European për sundim të ligjit në Kosovë, i aksesueshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=9476>

[20] Neni 162 i Kushtetutës së Kosovës, i aksesueshëm në https://www.scp-ks.org/sites/default/files/public/amendamenti_kushtetues_nr_24.pdf

[21] Ibid. Përshkrimi zyrtar i Zyrës së Prokurorisë së Specializuar e shpreh qartë gjenezën e krijimit të saj: "Zyra e Prokurorit të Specializuar (SPO) është një prokurori ndërkombëtare e krijuar për të hetuar dhe, nëse lind nevoja, për të ndjekur penalisht individë për krime të pretenduara në Asambenë Parlamentare të janarit 2011. Raporti i Këshillit të Europës (PACE) për trajtimin çnjerëzor të njerëzve dhe trafikimin e paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë. Burim i aksesueshëm në <https://www.scp-ks.org/sq/histori>

[22] Shih <https://www.scp-ks.org/sq>

[23] Shih https://www.scp-ks.org/sites/default/files/public/cis_thaci_et_al-alb.pdf

[24] Vetëm dy muaj pasi Kosova ndryshoi kushtetutën e saj për të krijuar gjykatën, BE nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, e cila shënoi hapin e parë formal në marrëdhëniet e Kosovës me BE-në dhe perspektivën e saj të anëtarësimit. Shih edhe https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/kosovo_en

[25] Shih edhe <https://research.un.org/en/docs/law/courts>

[26] Ibid.

[27] Ibid.

[28] Edhe për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, baza ligjore për funksionimin e Dhomave të Specializuara ishte Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin e mëvonshëm dhe jo drejtpërdrejt shkëmbimi i letrave. Shih gjithashtu https://www.zaoerv.de/76_2016/76_2016_4_a_967_9_92.pdf

[29] Neni 162/13 i Amendamentit Kushtetues

[30] Ibid, Neni 162/14

[31] Shih Nenet 4/1, 5 dhe 12 të Ligjit, publikuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Kosovës në https://www.new-perspektiva.com/wp-content/uploads/2018/01/LIGJI_NR_05_L-053_P-R_DHOMAT_E_SPECIALIZUARA_DHE_ZYR-N_E_PROKURORIT_T-SPECIALIZUAR.pdf. Shih edhe Ligjin 04/L-274 'Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit European mbi Misionin e Bashkimit European për Sundim të Ligjit në Kosovë', i aksesueshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=9476>

[32] Nenet 3/2 dhe 12 të Ligjit, ibid. Gjithashtu në faqen zyrtare të DhSK, shkruhet se Dhomat e Specializuara funksionojnë në bazë të ligjeve përkatëse të Kosovës, të drejtës zakonore ndërkombëtare si dhe të drejtave ndërkombëtare të njeriut. Shih edhe <https://www.scp-ks.org/sq/histori>

[33] Statuti i Romës i Gjykatës Ndërkombëtare Penale është traktati që themeloi Gjykatën Penale Ndërkombëtare (ICC). I aksesueshëm në <https://www.icc-cpi.int/sites/default/files/RS-Eng.pdf>

[34] Shih <https://unictr.irmct.org/>

[35] Shih <https://www.stl-tsl.org/en>

[36] Shih nenin 6 të Statutit të ICTY, të ndryshuar. I aksesueshëm në https://www.icty.org/x/file/Legal%20Library/Statute/statute_sept09_en.pdf

[37] Ibid.

[38] Neni 10 i ligjit. Ibid.

[39] Shih nenet 6, 14 dhe 15 të ligjit

[40] ICTY nuk ka pasur juridiksion lëndor për të ndjekur penalisht shtetet për agresion ose krime kundër paqes; këto krime janë në juridiksionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

[41] Nenet 8 dhe 9 të ligjit, ibid.

[42] Nga ana e saj, ICTY kreu një mision eksplorues në vendin e "Shtëpisë Yellow" famëkeqe, megjithëse vazhdoi në një mënyrë mjaft sipërfaqësore dhe me një standard profesionalizmi që shkakton njëfarë shqetësimi. Për më tepër, mandati i TPNJ-së është i kufizuar në një kornizë kohore dhe territor të përcaktuar qartë: ICTY është urdhëruar të gjykojë të dyshuarit për krime të kryera vetëm deri në qershor 1999, duke shënuar fundin e konfliktit të Kosovës, dhe juridiksioni i saj nuk shtrihej në Shqipëri, me përjashtim të rasteve ku Shqipëria mund të autorizonte shprehimisht hetimet që të zhvilloheshin në territorin e saj.

[43] https://www.icty.org/x/file/Legal%20Library/Statute/statute_sept09_en.pdf. Shih nenet 1-3.

[44] Shih <https://www.scp-ks.org/sq/histori>

[45] [https://www.scp-ks.org/sq/cases?title=&field case number value=&field case status id i18n=All](https://www.scp-ks.org/sq/cases?title=&field%20case%20number%20value=&field%20case%20status%20id%20i18n=All)

[46] <https://www.scp-ks.org/sq/cases/hashim-thaci-dhe-te-tjeret>

[47] Shih rregullën 88(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës. E aksesueshme në <https://www.scp-ks.org/sites/default/files/public/content/documents/ksc-bd-03-rev2-sqi-rulesofprocedureandevideance.pdf>

[48] Gjatë periudhës së pretenduar në aktakuzë, Hashim Thaçi ishte shef i Drejtorisë Politike dhe asaj të Informimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Në fund të marsit 1999, Thaçi ishte Kryeministër i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës (QPK) dhe Kryekomandant i UÇK-së. Kadri Veseli ishte anëtar i Drejtorisë Politike të UÇK-së dhe shef i shërbimit të zbulimit të UÇK-së. Në fund të marsit 1999, pas krijimit të QPK-së, ai u bë shef i Shërbimit Informativ të Kosovës dhe Ministër i Shërbimit Informativ në QPK. Rexhep Selimi ishte shef i Drejtorisë Operative të UÇK-së. Më së paku në gusht 1998, ai ishte Inspektor i Përgjithshëm i UÇK-së dhe në fund të marsit 1999, me krijimin e QPK-së, ai u bë ministër i Rendit Publik/ministër i Punëve të Brendshme. Jakup Krasniqi ishte anëtar i Drejtorisë Politike të UÇK-së dhe zëdhënës zyrtar i UÇK-së. Më vonë në 1998, ai u emërua zyrtarisht zëvendëskomandant i UÇK-së. Me krijimin e QPK-së, Krasniqi u bë zëdhënës i saj.

[49] Shih <https://www.scp-ks.org/sq/gjykatesi-i-procedures-paraprake-i-dhsk-se-konfirmon-aktakuzen-kunder-hashim-thacit-kadri-veselit>

[50] https://www.scp-ks.org/sites/default/files/public/cis_thaci_et_al-en.pdf

[51] <https://www.scp-ks.org/sq/cases/hashim-thaci-dhe-te-tjeret>

[52] Versioni i korrigjuar i dosjes paraprake të ZPS-së u dorëzua më 24 shkurt 2022 (gjithashtu si konfidencial). Më 9 qershor 2023, ZPS-ja dorëzoi një version konfidencial më pak të redaktuar të dosjes paraprake. Hashim Thaçi dorëzoi versionin e redaktuar publik të dosjes paraprake të tij më 8 nëntor 2022, Kadri Veseli më 13 mars 2023, Selimi e Krasniqi më 8 maj 2023 dhe ZPS-ja më 3 prill 2023.

[53] Më 26 tetor 2020, gjyqtari i procedurës paraprake konfirmoi aktakuzën kundër Hashim Thaçit ("Z. Thaçi"), Kadri Veseli ("Z. Veseli"), Rexhep Selimit ("Z. Selimi") dhe Jakup Krasniqit. Në KSC-BC-2020-06, F00026/RED, Gjyqtar i procedurës paraprake, Version i redaktuar publik i Vendimit për konfirmimin e aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veseli, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, 26 tetor 2020, publik; F00045/A03, Prokurori Special, Aktakuzë e Redaktuar më tej, 4 nëntor 2020, publike. Një version konfidencial

dhe më pak i redaktuar i aktakuzës së konfirmuar është dorëzuar më 11 dhjetor 2020, F00134, konfidencial. Pas vendimit për të metat në formën e aktakuzës, një version konfidencial i redaktuar, F00455/CONF/RED/A01, dhe një version i redaktuar publik, F00455/RED/A01, i aktakuzës së konfirmuar të korrigjuar u ngrit më 8 shtator 2021. version konfidencial, më pak i redaktuar i aktakuzës së konfirmuar, është ngritur më 17 janar 2022, F00647/A01. Shih https://repository.scp-ks.org/details.php?doc_id=091ec6e980d7fd63&doc_type=stl_filing&lang=sqi

[54] Shih transkriptet (versionet e redaktuara) të konferencave përgatitore në: <https://www.scp-ks.org/sq/cases/hashim-thaci-dhe-te-tjeret>

[55] Shih rregullin 86 dhe rregullin 95 të Rregullores, ibid.

[56] Shih <https://pace.coe.int/en/verbatim/2022-10-12/pm/en>

[57] “Në dritën e zhvillimeve të kësaj dekade, fakteve, provave dhe informacioneve të përditësuara, si dhe falë angazhimit, gatishmërisë dhe bashkëpunimit të plotë të Shqipërisë dhe Kosovës në shërbim të së vërtetës dhe vendosjes së drejtësisë, raporti famëkeq i Dick Marty nuk mund të gëzojë rezolutën mbështetëse në fuqi”, shkruhet në kërkesën e Shqipërisë drejtuar institucioneve më të larta të Këshillit të Europës.

[58] Shih <https://pace.coe.int/en/calendar/list/year/2023?prevMonth=8>

[59] Një amicus është një shtet, individi që nuk është në një çështje ligjore, por që merret me një ekspert informacion, ekspertizë ose mendime që ka një lidhje me çështjet në këtë rast. Përmbledhja e dorëzuar nga një amicus curiae në vendimarrjen për çështjen në fjalë, është në diskrecionin e gjykatës.

[60] Shih edhe <https://scholarship.law.duke.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1586&context=djci>